

“TRADE MINERALS AL” shpk

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E RAPORTIT TE THELLUAR TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER AKTIVITETIN FABRIKE PASURIM BAKRI

Sipas Ligjit 10440 date 7.7.2011 Per vleresimin e ndikimit ne mjedis aktiviteti klasifikohet ne Shtojcen 1, Pika 4.b Instalimet e projektuara per: Instalime per prodhimin e metaleve bruto johekur nga xeheroret, koncentratet ose materialet dytesore prej proceseve metalurgjike, kimike ose elektrolitike.



Vendndodhja e ushtrimit te aktivitetit : Fshati Gjegjan, Njesia Administrative Tërthore, Kukës

INVESTITOR : « *TRADE MINERALS AL* » shpk

PROJEKTUES : « *STUDIO PROJEKT* » shpk

TIRANE 2016

PERMBAJTJA E RAPORTIT TE THELLUAR TE VNM

Hyrje

1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM DHE METODIKEN E ZBATUAR

2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

3. NJE PERSHKRIM I ANALIZIMIT TE ALTERNATIVAVE TE MUNDSHME PER ZBATIMIN E PROJEKTIT OSE KOMPONENTEVE TE VECANTA TE TIJ (SI AKSESI RRUGOR, ADMINISTRIMI I MBETJEVE DHE UJERAVE TE NDOTURA , LLOJET E LENDEVE DJEGESE , VENDODHJA E PROJEKTIT ETJ) SI DHE SQARIMI I ARSYEVE KRYESORE PER ALTERNATIVEN E PROPOZUAR , DUKE MARR PARASYSH NDIKIMET NE MJEDIS TE SELICES ALTERNATIVE , SI DHE NE RAST SE KA MENDIMET DHE SUGJERIMET E INSTITUCIONEVE PERGJEGJESE QE MBULOJNE FUSHEN E ZBATIMIT TE PROJEKTIT.

4. NJE PERSHKRIM TE GJENDJES DHE VLERAVE EKZISTUESE TE MJEDISIT QE MUND TE NDIKOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR DUKE PERFSHIRE

5. NJE PERSHKRIM TE NDIKIMEVE NEGATIVE TE RENDESISHME TE PROJEKTIT TE PROPOZUAR MBI MJEDISIN KU PERFSHIHEN

6. NDIKIMET NE MJEDISIN NDERKUFITAR TE PROJEKTIT (NESE KA TE TILLA)

7. NDIKIMET POZITIVE NE MJEDISIN E ZONES SE PROJEKTIT

8. MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV TE IDENTIFIKUAR

9. PROGRAMIN E MONITORIMIT TE NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT

10. PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT

11. KONKLUZIONE

“TRADE MINERALS AL” shpk

HYRJE

Subjekti “TRADE MINERALS AL” Shpk kerkon te zhvilloj aktivitetin **Fabrike Pasurim Bakri**, me vendodhje ne fshatin Gjegjan, Njesia Administrative Tërthore, Kukes. Minerali i bakrit është mjaft i përhapur në rajonin Kukës-Has. Është i njohur vendburimi i Gjegjanit që ndodhet në serinë efuzivo-sedimentare me një sasi prej 3 600 000 ton me 3,5% Cu, i cili në pjesën më të madhe është shfrytëzuar.

Aktualisht shoqëria zoteron leje shfrytëzimi për mineralin e bakrit, nga kjo ka lind nevojë e ndertimit të fabrikes së pasurimit të tij, në afërsi të vendburimit që shfrytëzohet.

Raporti synon të japë një informacion të detajuar dhe të besueshëm lidhur me ndikimin mjedisor të projektit të propozuar, efektet lidhur me ndikimet në floren, faunen, ujë, emetimin e gazeve të sere në atmosfere, shkarkimet në toke, ujë, ndotjen akustike, si dhe ndikim social ekonomik në punësimin lokal, përmirësimin e infrastruktures dhe ndikimeve të tjera të rëndësishme mjedisore ose sociale, përfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet :

- Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit në fazën e përgatitjes së projektit.
- Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit.
- Të japë një gjendje sa më reale, nga pikepamja e ndikimit të aktivitetit
- Analizën e faktoreve pozitive e negative mjedisore, përcaktimin e masave zbutëse për reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.
- Propozime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

Projekti tenton përmirësimin e vlerave ekologjike e rikrijuese të territorit, gjatë shfrytëzimit të tij.

Për këto probleme u bë mbikqyrja e terrenit në të gjithë zonën, duke kryer vërtetime të ndryshme, si dhe të biodiversitetit.

Në raport jepet statusi i territorit, korniza ligjore e tij, mjedisi biofizik, gjeologjia e rajonit, gjeologjia e zonës ku do zhvillohet aktiviteti, hidrogeologjia dhe veçoritë kryesore të gjeologjisë së zonës .

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk është i rëndësishëm vetëm për njëzërit por është thelbësor dhe i nevojshëm për të gjitha qeniet në tokë. Njëzërit duhet të kuptojnë se si përdorimi i burimeve mjedisore dhe përfitimet që vijnë nga ato të mos demtohen por të jete e mundur të përfitohet sot dhe në të ardhmen.

“TRADE MINERALS AL” shpk

Termi mjedis dhe burime natyrore perdoren shpesh por jo gjithmone me kuptimin e qarte qe i perkufizon . Burimet natyrore i referohen burimeve te tokes, ujerave siperfaqesore dhe nentokesore , ajrit qe rrethon token, cdo gje qe rritet ne toke apo det si dhe burimet qe gjenden nentoke si psh mineralet. Mjedisi eshte me gjithperfshires, cdo gje qe na rrethon.

Thjesht duke perdorur burimet natyrore ne rrezikojme ne mbiperdorimin dhe shterimin e tyre . Shterimi i burimeve natyrore eshte nje nga problemet thelbesor te crregullimit te mjedisit. Ne te perfshihet shterimi i ujit, mineraleve perfshire dhe lendet fosile si dhe shume burime te tjera.

Cdo veprimtari e kryer nga njeriu shoqerohet edhe me impakt ne mjedis. Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit te mjedisit natyror nga aktiviteti njerezor.

Kemi dy tipe te impaktit mjedisor

- Shterimi i burimeve

- Ndotja

Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrushme. Pra zhvillimi i qendrushem i burimeve natyrore nuk eshte gje tjeter vecse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti len keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne.

Qendrushmeria perfshin menaxhimin e gjithe perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjithe. Zhvillimi i qendrushem nuk i pranon politikat te cilat cojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta (te varfera) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrushem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore.

Problemet mjedisore ne vendin tone lidhen me ndotjen e ajrit ne qytetet kryesore , ndotja e ujit e cila vjen nga shkarkimi i ujerave te ndotura pa u trajtuar fillimisht dhe mbetjet urbane te cilat jo te gjitha depozitohen ne vendet e caktuara.

1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM DHE METODIKEN E ZBATUAR

a-Pershkrim te qellimit dhe objektivave te VNM

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte nje proces ne vazhdimesi i aktivitetit dhe siguron se ndikimet mjedisore te rendesishme, sinjifikante jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim, zbatim te aktivitetit qe do te zhvillohet.

Qellimi i VNM- se

Qellimi i hartimit te raportit te VNM-se eshte percaktimi i efekteve negative dhe pozitive te aktivitetit dhe masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis si rezultat i zhvillimit te projektit.

VNM nuk do te mbuloj cdo aspekt te nje efekti mjedisor te projektit, me te njejtin nivel detajesh. Theksi do te vihet ne ndikimet kryesore qe shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu nje synim tjeter eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zhvillimit te aktivitetit dhe te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te aktiviteteve te propozuara.

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrueshmerise se mjedisit nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te ndikimeve te mjedisit qe ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit ne mjedis te aktivitetit
- Analizes se faktoreve pozitive e negative mjedisore dhe te masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimi cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne mjedis te projektit.

Objektivat e VNM

Objektivat e hartimit te VNM- se konsistojne ne evidentimin e ndikimeve ne mjedis, ne masat mbrojtese te flores dhe faunes dhe masat tekniko-organizative per nje zhvillim te qendrueshem te mjedisit, gjate kryerjes se aktivitetit minerar deri ne perfundim te aktivitetit dhe rehabilitimin e hapesires se shfrytezuar dhe te prekur nga aktiviteti, per nje mjedis te qendrueshem ne vitet pas ardhese.

Me kete studim informojme organet vendim-marres, mbi ndikimet ne mjedis dhe perfitimet e projektit te propozuar. Gjithashtu zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe zbatimi i projektit jo vetem nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose veprimtari, por krijon ndikim pozitiv ne disa drejtime si: zhvillim, punesim, rritje ekonomike dhe te ardhurave te pushtetit lokal e qendror, ne ndertimin e infrastruktures rrugore etj

Objektivat e tjera te studimit te paraqitur jane.

- Permiresimet mjedisore te zones ku zbatohet projekti dhe rreth saj.
- Perdorimin e burimeve natyrore ne menyren te qendrueshme ku respektohen dhe kerkesat e komunitetit te zones per rreth.
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale negative te projektit te zbatuar
- Lehteson informimin e organeve vendim-marrese, duke perfshire vendosjen e termave

“TRADE MINERALS AL” shpk

- dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.
- Mbrojtjen e shendetit te njeriut.
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit.
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peizazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve.
- Permireson aspektet sociale te projektit.

b) Pershkrim i permbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional qe lidhet me projektin

- VKM nr.686 date 29.7.2015 « *Per miratimin e rregullave , te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e Deklarates Mjedisore »*
 - Ligj nr 12/2015 per disa ndryshime ne ligjin nr. 10440 date 07.07.2011 « *Per vleresimin e ndikimit ne mjedis »*
 - VKM nr. 435 date 12.09.2015 « *Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise »*
 - VKM nr. 575 date 24.06.2015 “*Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte*”
 - VKM nr.419 date 25.6.2014 « *Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subject te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKLja.*
 - Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “*Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore*”
 - Vendim nr. 13 date 4.1.2013 « *Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
 - VKM nr. 765 date 07.11.2012 “*Per miratimin e rregullave per grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave te perdorura*”
 - Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 “ *Per Mbrojtjen e Mjedisit*”
 - Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “*Per menaxhimin e integruar te mbetjeve*”
- Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « *Per Lejet e Mjedisit »*
- Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « *Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
 - Ligj Nr 10304, datë 15.7.2010 “*Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë*”.
 - Ligj nr. 10266 date 15.04.2010 “*Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja*” per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 8897 dt. 16.05.2002 “*Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja*”
 - Udhezimin nr.12 date 15.06.2010 per disa ndryshime ne Udhezim nr. 6527 date 24.12.2004 “*Mbi Vlerat e lejueshme te elementeve ndotes te ajrit ne mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe menytrat e kontrollit te tyre*”

“TRADE MINERALS AL” shpk

- *Udhëzim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Urdhri e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhëzimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Udhëzim Nr 3, datë 17.05.2006 “Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret”*
- *VKM. Nr 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.*
- *Ligji Nr 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.*
- *Ligji Nr 9115, datë 27.02.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotur”. Të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.*
- *Ligji Nr 8906, datë 06.02.2002 “Për zonat e mbrojtura”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*

2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

a- Qellimin e Projektit te propozuar

Qellimi i ndertimit te fabrikes se pasurimit te bakrit me vendodhje ne fshatin Gjegjan, Njesia Administrative Terthore, Kukes eshte pasurimi i bakrit . Ky proces do te realizohet me ane te flotimit, qe konsiston ne pergatitjen e grimcave te mineralit per procesin e flotimit me ane te thyerjes dhe bluarjes, deri ne 90% -0.074 mm , me pas trajtimi i pulpes me reagente kimike dhe pasurimin me flotacion dhe ne fund quizimin (heqjen e ujit) e produkteve qe dalin nga pasurimi qe jane koncentratit dhe sterilet, nepermjet dekantimit dhe filtrimit.

Nga ana e shoqerise do te instalohen pajisje bashkohore te importuara nga jashte.

- b- Planimetria e vendodhjes se projektit , ku te pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes te shoqeruar me koordinatat sipas sistemit Koordinativ GAUS KRUGER, te dhena per perdorimin eksiztues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo instalimit te pajisjeve**

“TRADE MINERALS AL” shpk

Vendodhja e zhvillimit te aktivitetit

Fabrika e pasurimit te bakrit do te ndertohet ne fshatin Gjegjan, Njesia Administrative Terthore, Bashkia Kukes.

Vendodhja e fabrikes do te jete ne krahu e djathte te autostrades Kukes-Morine, ne distance ne vije ajrore rreth 150 m dhe rreth 10 m siper rruges se vjeter Kukes-Morine, rreth 100 m ne largesi nga galeria nr.5 e cila ka qen galeria kryesore prej nga ka dal minerali i bakrit nga miniera e Gjegjanit.

Qendra me e afert e banuar eshte fshati Gjegjan , rreth 800 m ne largesi nga vendi ku mendohet te ndertohet fabrika e pasurimit dhe ndodhen ne krahu e majte te autostrades Kukes-Morine.

Siperfaqja e parashikuar do te jete 6146 m² dhe koordinatat jane si me poshte ;


Nr.	X	Y
1	4457269	4663054
2	4457287	4663035
3	4457310	4663027
4	4457276	4662976
5	4457269	4662953
6	4457226	4662977
7	4457192	4663004
8	4457212	4663024
9	4457226	4663035

Siperfaqja e tokes ku mendohet te ndertohet fabrika nuk ka ndonje perdorim te vecante. Pjeserisht vendi ku do te ndertohet fabrika ka qen trimozh (vend-depozitim i mineralit prej nga ngarkohesh me mjete per ne uzine.) dhe pjesa tjeter eshte toke shkembore me pak bimesi mesdhetare shkurre dhe drure deri ne 1.5 m. Kjo zone eshte pjeserisht e ndotur nga sterilet e depozituara nga shfrytezimi i mineralit me karriere qe ndodhen vetem pak metra siper vendit ku do te ndertohet fabrike. Keto sterile jane ne sasira te konsiderueshme qe afersisht vleresohen 2-3 000 000 ton. Kjo e ben kete zone jo te preferuar nga banoret e zones per ta shfrytezuar ate per kullote.

Perfundimisht mund te themi se zona ku do te ndertohet fabrika nuk ka perdorim ekzistues.

Kjo fabrike pasurimi do te funksionoj persa kohe do te kere rezerva te shfrytezueshme te mineralit te bakrit nga miniera dhe karriera, nga studimet paraprake mendohet qe kohezgjatja te jete 5-10 vjet.

“TRADE MINERALS AL” shpk



“TRADE MINERALS AL” shpk



Pershkrimi Teknik i procesit te pasurimit

Fabrika e pasurimit parashikohet te ndertohet per pasurimin e mineralit te bakrit sipas lejes se shfrytezimit te marre nga subjekti "Trade Minerals Al" shpk. Qellimi i fabrikes se pasurimit eshte zvoglimi i dimensionit te kokrrizave te mineralit te bakrit nepermjet disa shkallve te thyerjes dhe bluarjes (sic do ta shpjegojme me vone) nga rreth 400 mm ne hyrje ne minus 0.125 mm dhe me pas nepermjet perdorimit te disa reagentave Kimik pasurimin e ketij minerali me qellim rritjen e permbajtjes se Cu ne produktin perfundimtar qe quhet koncentrat bakri deri ne 22% Cu duke e ndare nga mineralet e tjera te padobishme qe quhen sterile te cilat do depozitohen ne karrieren e minieres , pas procesit te filtrimit.

Lenda e pare qe quhet mineral ka ne perberje te saj elementet kimike si me poshte :

- 1- Cu 1.5-3.5 %.
- 2- S 25-40 %.
- 3- Fe25 35 %
- 4- Si3-10% .

Ne sasira me te vogla gjenden edhe elemente te tjere si Ca , Mg , Mn, Ca etj.

Ne forme gjurmesh gjenden dhe Au , Ag, Se, Te, etj

Sic u tha me lart ne fillim behet procesi i zvoglimit te grimces se mineralit nga 400 mm ne 100%-0.125 mm me qellim zberthimin e grimcave te bakrit nga mineralet e tjera bashkshoqerues te tij. Per kete minerali ne fillim nga miniera do depozitohet ne nje shesh qe ka permasa 20 x 50 m dhe pastaj minerali nepermjet 2 bunkerave i nenshtrohet procesit te thyerjes dhe sitisjes ne godinen e thyerjes ku behet thermimi i mineralit nga 400 ne 10 mm. Ne repartin e thyerjes pluhurat qe krijohen dalin ne atmosfere nepermjet sistemit te ventilimit., pasi kalojne ne filtrat e instaluar per kete qellim. Grimcat e hedhura ne atmosfere edhe nen veprimin e eres nuk shperndahen me larg se rreth 100 m nderkohe qe shtepite me te aferta nga vendi ku do te ndertohet fabrika jane poshte autostrades ne distance rreth 800 deri 1000m. E thene ndryshe keto pluhura kane zero ndikim ne komunitet. Mund te themi qe shtepia me e afert eshte mbi 300 metra me larg se shtepia e pare ne fabriken e vetme te pasurimit te bakrit ne Fushe Arrez. Levizja e mjeteve qe do te sjellin mineralin ne fabrike do behet nepermjet nje rruge ku largesia e rruges me shtepine me te afert eshte mbi 800 metra por megjithate do planifikojme dhe sperkatje gjate periudhes se veres.

Mbas procesit te thermimit , minerali i thyer dhe sitisur ne -10 mm kalon ne bunkerin e mineralit te imet dhe nga andej kalon ne procesin e zvoglimit te metejshem te grimces deri 100 % -0.125 mm nepermjet procesit te bluarjes dhe klasifikimit.

Gjate procesit te bluarjes minerali perzihet me ujin me densitet rreth 30 % te ngurte keshtu qe nuk kemi prezence te pluhurave. Mbas procesit te bluarjes minerali pergatitet per tju nenshtruar procesit te pasurimit.

Per kete qellim perdoren disa reagente kimik te cilat jane.

- 1- Gelqerja CaO ne masen rreth 15 Kg/ton mineral. Ky reagent perdoret per rritjen e PH it nga 7 ne rreth 11 ne procesin e pasurimit me flotim
- 2- Shkumezues te cilat mund te jene sapune te ndryshme si vaj pishe $C_{17}H_{33}COOH$ ose Flotanol i cili gjithashtu eshte reagent kimik organik i ngjashem me vajin e pishes , por me veti shkumezuese me te larte. Ky reagent ka nje doze perdorimi nga 20 deri 40 gr/ton.
- 3- Grupi i 3 i reagentave jane reagenta kolektor apo grumbullues qe gjithashtu jane komponime kimike organike Si te tille perdoren etil Ksantati i kaliumit C_2H_5OCSSK Butil ksantat kaliumi C_4H_9OCSSK , Amilksantat Kaliumi $C_5H_{11}OCSSK$ etj-Keto reagente perdoren nga 40- 100 gr/ton
- 4- Duke qen se krahas koncentratit te bakrit parashikohet te merret edhe koncentrat zinku per aktivizimin e bakrit dhe te zinkut do perdoren edhe disa reagente te tjere qe jane respektivisht per bakrin $Zn SO_4$ (sulfat zinku) dhe per zinkun $CuSO_4$ (sulfat bakri).
- 5- Per sulfitezimin e mineraleve oksid te bakrit qe mund te kete ky vendburim do perdoren sulfuri i natriumit Na_2S .

Mbas procesit te pasurimit dalin tre produkte :

- koncentratit qe i nenshtrohet procesit te heqjes se ujit nga 80 % ne 10 % H_2O nepermjet dekantimit dhe filtrimit
- koncentratit i zinkut qe i nenshtrohet procesit te heqjes se ujit njesoj si koncentratit i bakrit
- sterilet qe do kalojne ne procesin e dekantimit dhe filtrimit njesoj si koncentratit i bakrit dhe i zinkut

Ujerat qe do te dalin nga proceset e cuizimit te koncentrateve dhe sterileve do te riciklohen ne fabrike deri ne masen 100%.

Duhet te theksojme qe nga bashkimi i ujit me reagentat e ndryshem kimik nuk ka rrezik per probleme ekologjike ,as per demtim te faunes ujore. Nje gje e tille vertetohet edhe ne derdhjen e ujrave te dambes ne Fushe Arrez ku nga analizat qe u eshte bere ketyre ujrave ka rezultuar qe 50 m mbas bashkimit te ujrave te dambes me ujin e lumit Fan (qe ka prurje shume me te vogel se prurjet e lumit Drin i Zi dhe Drin i Bardh qe furnizojne liqenin e Fierzes) neutralizohet pH-i si dhe kemi prezencen e rritjes se peshkut.

Ne asnje rast sot ne fabrikat e pasurimit te bakrit nuk perdoren reagenta toksike sic jane cianuret KCN (cianur i kaliumit) etj qe kan qene perdorur shume heret ne Kurbnesh te Mirdites.

Parashikohet qe fabrika do te kete nje kapacitet perpunues rreth 30-35 t/ore.

Sasia e mineralit te bakrit si lende e pare qe do perpunohet ne dite do te jete 700-800 ton. Sasia e ujit qe nevojitet do jete 4-5 m³ per cdo 1 ton qe perpunohet qe i bie 4x30= 120 m³ ne ore ose 2m³ ne minut.

Sasia e koncentratit te bakrit qe do te dal pas procesit te pasurimit parashikohet 80-120 ton. Koncentrati i zinkut parsahikohet te jete 10-15 ton.

Sasia e sterileve do te jete rreth 600 ton/dite.

e- Menyrat dhe metodat qe do te perdoren per ndertimin e objekteve te projektit

1-Ndertimi i trasese se rruges me gjatesi rreth 800 m dhe gjeresi 4 m qe do te lidh karriren me fabriken do te behet me metoden e coptimit te materialit shkembor me matrapik te montuar ne krahun e eskavatorit. Trasea e rruges si kemi treguar dhe me siper do te ndertohet ne territorin e fabrikes.

2-Objektet e sherbimit do te jene me konstrukcion sanduici dhe do te vendosen ne bazamente betoni ose trare ne lartesine 40cm nga toka. Objektet e sherbimit si zyrat, te sherbimit te punonjesve si garderobe, dhome te ndihmes se shpejte, mense, fjetinat etj keto objekte do te jene kontoniere me sanduic te mobiluar.

3-Vaskat e dekantimit te mbetjeve te ngurta do te hapen ne sheshin fundor te fabrikes me thellesi 2m, gjeresi 4m gjatesi 6m te rrethuara dhe te lidhura ne hyrje me kanalin e percjelljes se ujit te turbulluar dhe ne dalje me kanalin e percjelljes se ujit te paster.

4-Furnizimi me energji elektrike i objektit do te behet me nje lidhje te re nga linja ekzistuese qe kalon ne afersi te fabrikes. Menyra e furnizimit te kabines nga linja elektrike mund te behet me linje kabllore ose linje ajrore. Varianti me i mire do te percaktohet nga specialistet e OSHEE.

ë- Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje dhe energji).

Fabrika do te ndertohet me konstruksion metalik dhe brenda reparteve do te ndertohen bazamente betoni (mbi shkeminj qe ndodhen ne vendin ku do ndertohet fabrika) per vendosjen e makinerive te ndryshme te fabrikes. Per dergimin e mineralit nga karriera ne fabrike do hapet nje rruge rreth 500 m me gjeresi 4 m.

Konstruksionet metalike do te instalohen nga subjekte te specializuara ne kete fushe. Objektet e sherbimit , mensa, zyrat, fjetinat, garderobat etj do te jene kontenier sanduic te gatshem te mobiluar.

Pjesa e bazamenteve te betonit per instalimin e pajisjeve do te realizohet nga subjekt te kontraktuar qe operojne ne fushen e ndertimit.

Furnizimi me energji elektrike i objektit do te behet me nje lidhje te re nga linja ekzistuese qe kalon ne afersi te fabrikes. Menyra e furnizimit te kabines nga linja elektrike mund te behet me linje kabllore ose linje ajrore. Varianti me i mire do te percaktohet nga specialistet e OSHEE.

Si burime furnizimi me uje teknologjik do perdoret uji qe rrjedh ne dy lugina dhe distance nga 300 ne 600 metra nga fabrika nepermjet dy stacioneve te pompimit si dhe nga riciklimi afersisht i plote i tij

Per uje te pijshem do perdoren disa burime te zones dhe nepermjet pompave do degohet ne fabrike.

Per nevojat e fabrikes do behet studim i detajuar mbasi te porositet fabrika por nga eksperienca te ngjashme ne kete fushe sasia e energjise qe do kerkoet eshte nga 15000 deri 25000 Kw ne 24 Ore 0se 700 deri 900 kw/ore.

f-Informacion per lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese prane zones se projektit.

Vendburimi i bakrit Gjegjan eshte shfrytezuar edhe vite me pare, dhe minerali i prodhuar eshte derguar ne uzinen e shkrirjes se bakrit ne Rexhepaj, Kukes. Nga analiza qe i eshte ber vendburimit ekzistues rezulton se ka akoma rezerva te shfrytezueshme si ne punime siperfaqesore dhe nentokesore. Subjekti aktualisht shfrytezon mbetjet nga punimet siperfaqesore te karrieres ekzistuese. Si rezultat i kesaj ka lindur nevoja e ndertimit te fabrikes se pasurimit sepse kemi te bejme me rezerva me permbajtje me te ulet te bakrit .

Pra si perfundim mund te themi se aktiviteti qe kerkon te zhvilloj shoqeria eshte i lidhur me aktivitetin mineral te viteve te kaluara.

3. NJE PERSHKRIM I ANALIZIMIT TE ALTERNATIVAVE TE MUNDSHME PER ZBATIMIN E PROJEKTIT OSE KOMPONENTEVE TE VECANTA TE TIJ (SI AKSESI RRUGOR, ADMINISTRIMI I MBETJEVE DHE UJERAVE TE NDOTURA , LLOJET E LENDEVE DJEGESE , VENDODHJA E PROJEKTIT ETJ) SI DHE SQARIMI I ARSYEVE KRYESORE PER ALTERNATIVEN E PROPOZUAR , DUKE MARR PARASYSH NDIKIMET NE MJEDIS TE SELICES ALTERNATIVE , SI DHE NE RAST SE KA MENDIMET DHE SUGJERIMET E INSTITUCIONEVE PERGJEGJESE QE MBULOJNE FUSHEN E ZBATIMIT TE PROJEKTIT.

Shoqeria TRADE MINERALS AL shpk aktualisht zhvillon aktivitetin e shfrytezimit te mineralit te bakrit ne minieren ekzistuese ne vendburimin Gjegjan.

Perzgjedhja e vendit ku do te ndertohet fabrika eshte ber duke patur parasysh:

- 1- Distanca e afert me karrieren dhe minieren
- 2- Distanca e afert me linjen e rrjetit elektrik
- 3- Pjerresine e terrenit ku do te ndertohet objekti
- 4- Distanca me te afert te mundshme te furnizimit me uje duke qen se procesi i pasurimit kerkon sasira te medha uji
- 5- Lidhjet e aksesit me rruget nacionale , distanca e afert me autostraden Kukes-Morine
- 6- Largesia nga zona me e afert e banuar
- 7- Shfrytezimi i terrenit shkembor me shume pak bimesi

Duke patur parasysh keta faktor nuk eshte pare e nevojshme alternative tjeter vendodhje per ndertimin e fabrikes se pasurimit te bakrit.

4. NJE PERSHKRIM TE GJENDJES DHE VLERAVE EKZISTUESE TE MJEDISIT QE MUND TE NDIKOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR DUKE PERFSHIRE

4.1 Pershkrim te karakteristikave fizike te zones se projektit

Fabrika e pasurimit te bakrit do te ndertohet ne fshatin Gjegjan, Njesia Administrative Terthore, Bashkia Kukes.

Vendodhja e fabrikes do te jete ne krahun e djathte te autostrades Kukes-Morine, ne distance ne vije ajrore rreth 150 m dhe rreth 10 m siper rruges se vjeter Kukes-Morine, rreth 100 m ne largesi nga galeria nr.5 e cila ka qen galeria kryesore prej nga ka dal minerali i bakrit nga miniera e Gjegjanit.

Qendra me e afert e banuar eshte fshati Gjegjan , rreth 800 m ne largesi nga vendi ku mendohet te ndertohet fabrika e pasurimit dhe ndodhen ne krahun e majte te autostrades Kukes-Morine.

Njesia Administrative Terthore eshte nje nga njesite e Bashkise Kukes. Karakteristikë e kësaj Njesie është se shtrihet tërësisht në kufi me Kosovën. Një tjetër karakteristikë e saj është se autostrata Durrës-Morinë, kalon përmes të gjithë territorit të fshatrave të kësaj njesie. Dogana e Morinit, që ndodhet në territorin e saj është një nga Doganat më të rëndësishme të vendit. Vetëm gjatë muajve të verës lëvizin rreth 2 milion veta që hyjnë në territorin shqiptar. Ka qënë një nga zonat më të njohura në vend për shkak të nxjerrjes së mineralit të Bakrit nga miniera e Gjegjanit. Kufiri perëndimor që e ndan Njesine me zonën e Hasit, preket tërësisht nga ujrat e liqenit të Fierzës.

Sipërfaqja e tokës së punueshme në këtë njesi është rreth 874 ha, ndërkohë që cilësitë e tokës janë jo shumë të mira kjo për arsye se toka e punueshme në këtë komunë shtrihet në një terren tërësisht malor dhe me pjerrësi të konsiderueshme.

- Përshkrim i faktoreve klimatike

Faktoret e formimit të klimes grupohen në faktore kozmike, planetare (Tokesore) dhe lokale. Në grupin e parë hyjnë karakteristikat e qendrueshme ose të ndryshueshme të Diellit dhe të hapësirës kozmike, në grupin e dytë karakteristikat e të gjithë sipërfaqes së tokës dhe të atmosferës, kurse në grupin e tretë karakteristikat e qendrueshme ose të ndryshueshme të ajrit dhe të tokës së vendit në fjalë. Në teresinë e faktoreve klimeformues është e vështirë të bëhet një renditje e sakte, për arsye se secili prej tyre ndikon vazhdimisht në formimin e klimes, nderkohe që roli dhe rëndësia e tyre është e ndryshueshme në vende të ndryshme. Në rast se do të bënim një fare renditje, atëherë në radhë të parë duhet të vendosim rrezatimin diellor, sepse sasia dhe intensiteti i tij përcaktojnë karakteristikat themelore të klimes. Ndikim të madh në klimën e vendit tone kanë detet Adriatik dhe Jon. Deti Adriatik duke qenë i rrethuar nga Gadishulli i Ballkanit dhe i Apenineve është relativisht i ftohtë dhe për këtë arsye roli i tij zbutës mbi klimën është më pak i ndjeshëm sesa i detit Jon. Deti Jon duke qenë i hapur nga jugu, rrihet me teper nga ererat e ngrohta të Afrikës, ky det i jep klimes jugperendimore të Shqipërisë një karakter edhe më të theksuar mesdhetar.

Klima karakterizohet nga një dimër i ashpër dhe një verë e nxehtë. Temperatura mesatare vjetore në rrethin e Kukësit sillet rreth 11,9 °C. Temperaturat mesatare ekstreme sillen nga 3,9 deri 25,4 °C. Reshjet vjetore mesatare sillen nga 800 deri në 1100 mm. Shpejtësia mesatare e erës është 3,5 m/s në dimër, 3,1 m/s në pranverë dhe 2,3 m/s në vjeshtë. Trashësia e shtresës së borës është në varësi të drejtpërdrejtë me lartësinë mbi nivelin e detit dhe nga ekspozimi i shpatëve. Zakonisht ajo lëviz nga 40 cm deri në 200 cm. Shtresa e dëborës mesatarisht zgjat 35-40 ditë.

-Pershkrim i ujerave sipërfaqesore dhe nëntokësore ne zonen e projektit

Rezervat ujore të rrethit të Kukësit përfaqësohen nga ujrat sipërfaqësore dhe nëntokësore, të cilat janë të shumta dhe të pashtershme. Hidrografia e rrethit të Kukësit përfaqësohet nga rrjedhja e poshtme e Drinit të Zi dhe Drinit të Bardhë, gjithashtu dhe degëve të tyre, si lumi i Lumës, i Bushtricës, përrenjve të shumtë dhe një numër i madh burimesh nëntokësore kryesisht burime karstike. Janë zbuluar ujëra nëntokësore që nevojiten për të pirë dhe për ujitje në fshatra Llugaj, Kam etj. Rrjedhja ujore e Drinit të zi dhe Drinit të Bardhë formohen si rezultat i reshjeve që bien në pellgun e tyre, ndërsa Drini i Zi ushqehet direkt nga Liqeni i Ohrit.

Liqeni artificial i Fierzës është krijuar në shtratin e lumit Drin në vitin 1978, në funksion të hidrocentralit të Fierzës.

Ky është një liqen oligotrof dhe ka një bosht gjatësor prej 70 kilometër dhe me një sipërfaqe maksimale prej 7 mijë hektarësh, ku 5 mijë hektarë merren në konsideratë për qëllimin e rritjes dhe kultivimit të peshkut. Ky liqen ka lartësi 167 metra, sipërfaqe të pasqyrës së ujërave prej 72,5 km², thellësinë më të madhe prej 128 metra dhe një vëllim prej 2,7 miliardë metër kub ujë. Sipërfaqja e përgjithshme e pellgut ujëmbledhës është 11.829 km². Kapaciteti maksimal ujëmbajtës i Liqenit të Fierzës, arrin rreth 3,2 miliardë metër kub ujë, ndërkohë që kapaciteti minimal, i cili mund të shkaktojë edhe situatat më kritike të prodhimit të energjisë elektrike, është rreth 1,2 miliardë metër kub ujë.

Liqeni shërben edhe si nyje lidhëse mes banorëve të rretheve Kukës, Tropojë, Has dhe Pukë. Gjithashtu, ky hidrocentral shërben si rregullator i furnizimit me ujë për dy hidrocentralet e ngritura në kaskadën e Drinit, atë të Vaut të Dejës dhe Komanit.

4.2 Pershkrim i biodiversitetit ne zonen e projektit

Problemet e biodiversitetit perbejne aktualisht nder problemet me me rendesi ne rruzullin tokesor. Termi biodiversitet eshte shume kompleks dhe si i tille, zhvillimi dhe percaktimi i strategjive te pershtatshme per mbrojtjen e tij, shoqerohet me nje proces te veshtire zgjedhjesh dhe vendimmarrjesh. Biodiversiteti perben teresine e llojeve dhe ekosistemeve ne nje rajon, apo ne gjithe rruzullin tokesor. ekosistemet jane te nje rendesie te vecante sepse ato perbejn bazat per ekzistencen e llojeve. Cenimi i tyre, si rezultat i aktiviteteve te ndryshme ekonomike shoqerore perben nje shqetesim per njerezit dhe studiuesit . Vlera e nje biodiversiteti te larte per njerezimin jepet para se gjithash nepermjet funksionit te tij si stabilizator i biosferes dhe si burim direkt i prodhimit.

- Pershkrim te habitateve kryesore ne zonen e projektit si dhe harta ilustruese

Aktiviteti i propozuar do te zhvillohet ne fshatin Gjegjan, Njesia Administrative Tërthore, Kukes. Ne afersi te zones se propozuar per ngritjen e fabrikes se pasurimit te bakrit ndodhet edhe karriera e shfrytezimit te ketij minerali, e cila u vendos ne shfrytezim ne 1962 , minerali i bakrit ka qen i vetmi me cikël nxjerrës e perpunues brenda vendit. Siperfaqja ku do te instalohet fabrika e pasurimit te bakrit eshte e varfer ne bimesi, kjo pershkak te aktivitetit te shfrytezimit te bakrit.



- Pershkrim te vegjetacionit ne secilin habitat dhe statusin e ruajtjes kombetare dhe nderkombetare te tyre

Vendburimi i bakrit Gjegjan eshte shfrytezuar per rreth 30 vite me radhe, minerali transportohej ne largesi rreth 10 km ne Uzinën e shkrirjes se bakrit ne Rexhepaj Kukes. Shapti i Gjalicës vazhdon të ruajë brezin “shterpë” inproduktiv të krijuar nga tymrat e Uzinës. Asnjë bimësi në afërsi të saj nuk ka mbirë ende edhe pse kanë kaluar gati 21 vite nga mbyllja e saj. Në tokat bujqësore të Shtiqnit, ende ndjehen efektet e squfurit dhe sulfatit të bakrit. Shtresa ngjyrë blu në të gjelbërt ende mbulon një pjesë të sipërfaqes bujqësore me një shkallë të konsiderueshme intoksikimi dhe ndikim negativ në farërat dhe kulturat bujqësore

Persa i perket flores se rajonit te komunes Tërthore, Zona e shkurreve, shtrihet në lartësinë 600-750 metra mbi nivelin e detit Zona e dushkut, shtrihet në lartësinë 750 – 900 metra mbi nivelin e detit Zona e ahut, shtrihet në lartësinë nga 900-1200 m, Zona alpine, ka shtrirje mbi 1200 m. Kodra e Gjegjanit Maja e Morthit ka nje lartesi 504 m mbi nivelin e detit, bimesia paraqitet e varfer dhe vende-vende e zhveshur.

Në zonën e komunes ndodhen një sasi e konsiderueshme bimësh medicinale. Zona e Tërthores është vendi ku rritet bima e sherebelës, trumez, sansi I njome, shtogu, moll ate egra.

- Pershkrimin e Faunes ne secilin habitat dhe statusin e ruajtjes kombetare dhe nderkombetare te tyre

Duke analizuar komponentet e vecante te natyres shqiptare (ndertimin gjeologjik, relievin, klimen, bimesine etj) eshte theksuar origjinaliteti dhe shumellojshmeria e tyre. Ketij rregulli te pergjithshem I nenshtrohet edhe bota e kafsheve te egra, e cila eshte e shumellojshme dhe ne disa raste origjinale dhe endemike. Nder elementet e mjedisit natyror rendesi te vecante per rritjen e perhapjen gjeografike te kafsheve te egra kane klima, bimesia, pasurite ujore, relieve etj.

Ne teresine e tyre pasurite e medha ujore te Shqiperise , krijojne kushte te volitshme jetesore per kafshet ne cdo zone gjeografike, ne cdo lartesi dhe ne cdo stine te vitit.

Ne kete grup te madhe te faunes hyjne kafshet gjitare te tokes (mishngrenese dhe barnngrenese) , shpezet, zvarraniket, amfibet , insektet etj

Te gjitha kafshet tokesore te vendit tone jane pothuajse te njejta ose te ngjashme me ato te krejt mesdheut , por sidomos me ato te Mesdheut europian. Ky unitet faunistik lidhet me faktin qe gjithë Mesdheu formon nje njesi me vete faunistike ne kuadrin e zones Paleoarktike, e cila nga ana e vet ben pjese ne nje njesi me te madhe faunistike, ne treven Holarktike. Ne pergjithesi fauna e Mesdheut nuk dallon per forma te shumta endemike, por ajo permendet per numrin e madh te perfaqesuesve te disa llojeve te kiroptereve, butakeve, zvarranikeve, te disa insekteve etj. Fauna tokesore e vendit tone me gjithë demtimet eshte ende e pasur. Ajo ka perfaqesuesit e vet ne te gjitha krahinat e zonat gjeografike te vendit dhe ne te gjitha lartesite , ku formohen biocenoza te caktuara.

Fauna e Komunës Tërthore është e larmishme dhe e pasur. Nga gjitarët e mëdhenj që bëjnë pjesë në këtë zonë janë: ujku (canis lupus), dhelpra (vulpes vulpes), derri i egër (sus scrofa), ariu (ursus ardos), etj. Ndër shpendët kryesorë mund të përmendim: harabelët (passeriformes), qukapikët, gushëkuqin (erithacus rubecula), mëllenja (turdus merula) etj.

Lepuri i egër është mjaft i përhapur në Komunën e Tërthores. Në pyjet e Koritnikut jetojnë lepuj të egër, dhelpra, nusja e lalës, shqarhi, bulku, ujku, dhia e egër, ariu, derri i egër etj. Gjatë periudhës së tranzicionit si rezultat i gjuetisë së paligjshme këto kafshë janë dëmtuar aq shumë sa numri i tyre është ulur në nivel kritik. Ndër shpendët e egër më të përhapur janë sorra, thëllënxa, pëllumbi i egër, shqiponja, skifteri etj. Edhe këto shpendë janë të rrezikuar nga gjuetia e paligjshme.

*- Përshkrimin e zonave të Mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti ,
përfshirë edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj*

Zona ku do të ndërtohet fabrika e pasurimit ndodhet në afërsi të karrierës së Gjogjanit e cila është shfrytëzuar vite me pare. Në afërsi të kësaj zone nuk kemi zonë të Mbrojtura apo monumente natyrore të mbrojtura me ligj.

4.3 Përshkrim i cilësive të mjedisit dhe ndikimeve ekzistuese

- Cilësia e ujërave në zonën e studiuar për hartimin e raportit të Thelluar të VNM-së

Me zhvillimin dhe rritjen e popullsisë, rritet edhe kërkesa për ujë të një cilësie të mirë, për higjienën vetjake, turizëm, vaditje në bujqësi, përdorim në blegtori, energjetikë, për ftohje në termoenergjetikë dhe industri, si dhe për peshkim, akuakulturë, lundrim etj. Këto aktivitete, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndikojnë në cilësinë e ujërave. Burimet kryesore të ndotjes së ujërave në Shqipëri në dhjetëvjeçarën e fundit janë shkarkimet urbane. Ujërat e zeza urbane dhe shkarkimet e tjera industriale derdhen drejtpërdrejt në kanalet ujëmbledhëse dhe shkojnë në lumenj, liqene ose bregdet.

Në afërsi të zonës që do të shfrytëzohet ndodhet liqeni artificial i Fierzes, krijuar në shtratin e lumit Drin. Duke qenë se zona nuk ka një popullim të madh, ujërat e zeza të fshatrave përreth janë sistemuar me gropa septike cilësia e ujit të këtij liqeni është në parametra normale dhe jo i ndotur.

- Cilësia e ajrit në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së

Përsa i përket cilësive të ajrit në zonë ai konsiderohet me parametra të pranueshëm duke qenë se ndodhet larg zonave të banuara. Edhe zhvillimi i aktivitetit të pasurimit të bakrit nuk do të shkaktojë ndotje të ajrit sepse nuk do të ketë emetime të gazeve ndotes. Sterilet nuk krijojnë pluhura gjatë transportimit dhe depozitimit në karriere sepse kanë përmbajtje të lartë uji nga procesi i pasurimit. Pas depozitimit dhe tharjes së tyre nga kushtet atmosferike do të mbulohen me sterile të karrierës për të mos lejuar ngritjen e grimcave të imeta në atmosferë, duke patur parasysh që këto grimca kanë një granulometri të vogël.

Të vetmet emetime në ajër do të vijnë nga djegia e lëndës djegëse të mjeteve të transportit, por që do të jete në nivele të paperfillshme.

- Niveli i zhurmave ne zonen e studiuar per hartimin e raportit te thelluar te VNM-se

Ne afersi te projektit nuk ka veprimtari te cilat te shkaktojne zhurma mbi nivele te lejuara dhe te shkaktojne ndotje akustike. Aktiviteti i shfrytezimit te mineralit te bakrit ne karrieren ekzistuese te Gjeganit nga shoqeria nuk shkakton zhurma ne nivele te larta dhe shqetesuese per banoret.

- Administrimi i mbetjeve ne zonen ku propozohet projekti

Zona ku do zhvillohet aktiviteti eshte ne largesi rreth 800 m nga zona me e afert e banuar qe eshte fshati Gjegan . Mbetjet urbane qe do te krijohen nga aktiviteti i perditshem i punonjesve do te depozitohen ne kontenier plastike te vecante dhe me pas do te evadohen drejt venddepozitimeve te caktuara. Zonat e banuara ne afersi kane venddepozitimet e tyre per mbetjet urbane.

- Probleme te tjera nese evidentohen te tilla si erozioni i tokes, zjarret, ndotje historike etj
Dihet se intensiteti i erozionit varet nga faktoret fiziko-geografike si perberja litologjike , relievi (kryesisht pjerresia e tij), kushtet klimatike , shkalla e mbuleses me bimesi dhe tipi i saj dhe nga veprimtaria prodhuese e njeriut. Terreni kodrinor-malor i zonës favorizon fenomenin e erozionit është e domosdoshme të punohet për mbrojtjen e tokës nga ky fenomen, duke ndërtuar prita malore apo sistemimin e tokës, si dhe kanalizimin për kullimin e ujërave atje ku ndihet e domosdoshme.

Zjarret kane qen shqetesuese per komunitetin, ne disa raste edhe te qellimshme nga njerez te pandergjegjshem per te rritur siperfaqe te kullotave apo edhe faktore te tjere jane krijuar vatra zjarri. Ne kete drejtim kane qen te shpejta nderhyrjet nga organet e pushtetit vendor dhe komunitetit dhe kohet e fundit edhe si faktore I ndergjegjesimit te komunitetit nuk ka patur raste te djegies se parcelave dhe demtimit te pyjeve ne rajonin ku do zbatohet projekti.

Fabrika e pasurimit te bakrit do te ndertohet ne afersi te karrieres ekzistuese te shfrytezimit te bakrit, vendburimi Gjegan. Bimesia e zones eshte e demtuar per shkak te funksionimit te meparshem te kesaj miniere si dhe uzines ne Rexhepaj Kukes. Shapti i Gjalicës vazhdon të ruajë brezin “shterpë” inproduktiv të krijuar nga tymrat e Uzinës. Asnjë bimësi në afërsi të saj nuk ka mbirë ende edhe pse kanë kaluar gati 21 vite nga mbyllja e saj. Në tokat bujqësore të Shtiqnit, ende ndjehen efektet e squfurit dhe sulfatit të bakrit. Shtresa ngjyrë blu në të gjelbërt ende mbulon një pjesë të sipërfaqes bujqësore me një shkallë të konsiderueshme intoksikimi dhe ndikim negative në farërat dhe kulturat bujqësore. Në breg të lumit Luma, pak metra nga rrënojat e Uzinës së Bakrit, janë të depozituara miliona metër kub skorje (mbetje nga shkrirja e bakrit me përbërje squfuri, karboni e kimikate të tjera). Largimi dhe asgjësimi i tyre është tërësisht i pamundur, për shkak të volumit të madh por edhe të

mos shpërbërjes së tyre me elemente të tjerë kimik. Që prej afro 45 vitesh këto depozitime me skorje, përshkohen nga lumi Luma, derdhja e të cilit përfundon në liqenin e Fierzës.

- Presionet kryesore të mjedisit në zonën e projektit (të tilla si ndotjet e mjedisit, prerje pyjesh etj)

Ndikimi i njeriut në mjedis vitet e fundit ka rënë, në rajon nuk priten dru për përdorim nga banorët. Shkurret dhe druret janë pjesë e rëndësishme e mbulesës bimore, jo vetëm për evoluimin e peizazhit por edhe për arsye sepse ato janë përcaktuese për mbrojtjen nga erozioni.

4.4 Përshkrim i karakteristikave sociale të zonës ku propozohet projekti

- Njësia e qeverisjes vendore që administrojnë zonën ku zbatohet projekti

Aktiviteti do të zhvillohet në afërsi të fshatit Gjogjan, Njësia Administrative Terthore, Bashkia Kukes.

- Popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike të zonës

Zona përreth (objektit) është pak e banuar. Njësia Administrative Terthore është një nga njësitë e Bashkisë Kukes. Karakteristikë e kësaj Njësie është se shtrihet tërësisht në kufi me Kosovën. Një tjetër karakteristikë e saj është se autostrata Durrës-Morinë, kalon përmes të gjithë territorit të fshatrave të kësaj njësie. Dogana e Morinit, që ndodhet në territorin e saj është një nga Doganat më të rëndësishme të vendit. Vetëm gjatë muajve të verës lëvizin rreth 2 milion veta që hyjnë në territorin shqiptar. Ka qënë një nga zonat më të njohura në vend për shkak të nxjerrjes së mineralit të Bakrit nga miniera e Gjogjanit. Kufiri përëndimor që e ndan Njësine me zonën e Hasit, preket tërësisht nga ujrat e liqenit të Fierzës.

Sipërfaqja e tokës së punëshme në këtë njësi është rreth 874 ha, ndërkohë që cilësitë e tokës janë jo shumë të mira kjo për arsye se toka e punëshme në këtë komunë shtrihet në një terren tërësisht malor dhe me pjerrësi të konsiderueshme.

Popullsia e kësaj njësie përbëhet nga 3850 banorë që janë të organizuar në rreth 713 familje. Rreth 65% e këtyre familjeve të Njësise Administrative Terthore merren me bujqësi. Bujqësia është një aktivitet që i ndihmon fshatarët mjaft në jetesën e tyre. Numri mesatar i antarëve të çdo familjeve të kësaj zone është 4-5 persona. Aktivitetet tjetër i tyre është dhe blegtoaria, nga ku banorët e zonës kanë mjaft fitim. Aktivitetet tjetër janë bimët e arave, frutikultura etj.

- *Perdorimi i tokes ne zonen e projektit*

Zhvillimi i projektit te ndertimit te fabrikes se pasurimit te bakrit do te behet brenda siperfaqes se kerkuar nga shoqeria dhe qe do te miratohet Leja e Ndertimit.

Sheshet e depozitimit te sterileve , vendosjes se konteniereve sanduic qe do sherbejn si zyra dhe ambjent sherbimi , fjetinat, mensat etj do te vendosen brenda kesaj siperfaqeje dhe aktiviteti nuk do te kerkoj toke tjeter shtese per funksionimin e tij.

- *Vlera dhe objektet monumentale dhe arkeologjike ne afersi te zones se projektit*

Lidhja e objektit me rruge ekzistuese dhe ushtrimi i aktivitetit nuk prek zonat turistike dhe zonen e mbrojtur.

- *Administrimi i mbetjeve dhe ujerave te ndotura urbane*

Administrimi i mbetjeve urbane ne vendin tone eshte i decentralizuar. Ne pjesen me te madhe te qyteteve sherbimet e mbledhjes dhe transportimit te mbetjeve kryhet nga kompani private te menaxhimit te mbetjeve, te cilat jane te kontraktuara nga bashkitë. Ne shumicen e bashkive te vendit, tarifa per menaxhimin e mbetjeve përfshin grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve deri ne venddepozitim. Zonat rurale ne vendin tone nuk jane te mbuluara akoma nga sherbimet e menaxhimit te mbetjeve. Pjesa me e madhe e mbetjeve te këtyre zonave depozitohen neper lumenj ose ne ane te rrugëve te cilat pastrohen nga Ujërat dhe ne këte mënyre zhvendosen ne një pjesë tjetër toke dhe ne fund ne rrjedhjet ujore. Zonat e banuara ne afersi kane venddepozitimet e tyre per mbetjet urbane.

Persa i perket ujerave te zeza ne fshatra ato jane te sistemuara ne gropa septike.

5. NJE PERSHKRIM TE NDIKIMEVE NEGATIVE TE RENDESISHME TE PROJEKTIT TE PROPOZUAR MBI MJEDISIN KU PERFSHIHEN

5.1 Ndikimet negative ne mjedis

- *Ndikimet negative ne karakteristikat fizike te zones se projektit*

Gjate ndertimit te fabrikes se pasurimit , do te kete ndryshime te vogla ne topografine lokale. Ne projekt eshte parashikuar nje radhe per nivelimin e zones ku do te vendosen objektet e fabrikes si dhe te sherbimit.

Per shmangien dhe parandalimin e erozionit si dhe per ruajtjen e regjimit te rrymes se ujit te parametrave hidrodinamike te saj, ne projekt eshte percaktuar edhe ndertimi i kanaleve perimetrike per grumbullimin dhe rrjedhjen e tyre .

- *Ndikimet negative ne habitate dhe biodiversitetin e zones se projektit*

Siperfaqja e tokes ku mendohet te ndertohet fabrika nuk ka ndonje perdorim te vecante. Pjeserisht vendi ku do te ndertohet fabrika ka qen trimozh (vend-depozitim i mineralit prej nga ngarkohesh me mjete per ne uzine.) dhe pjesa tjetere eshte toke shkembore me pak bimesi mesdhetare shkurre dhe drure deri ne 1.5 m. Kjo zone eshte pjeserisht e ndotur nga sterilet e depozituara nga shfrytezimi i mineralit me karriere qe ndodhen vetem pak metra siper vendit ku

do te ndertohet fabrike. Keto sterile jane ne sasira te konsiderueshme qe afersisht vleresohen 2-3 000 000 ton. Kjo e ben kete zone jo te preferuar nga banoret e zones per ta shfrytezuat ate per kullote.

Perfundimisht mund te themi se zona ku do te ndertohet fabrika nuk ka perdorim ekzistues. Kjo fabrike pasurimi do te funksionoj persa kohe do te kere rezerva te shfrytezueshme te mineralit te bakrit nga miniera dhe karriera, nga studimet paraprake mendohet qe kohezgjatja te jete 5-10 vjet.

Nga ky aktivitet nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar dhe e listuar ne urdherin e Ministrit nr.1280,dt.20.11.2013 'Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes se eger'. Nga subjekti ne zbatim te projektit do te merren masa qe zona ne shfrytezim te jete gjithmone e kufizuar dhe te rehabilitohet. Zona e kerkuar nuk perfaqeson zone me rendesi te vecante dhe per ketë arësyë nuk është parashikuar sipas Strategjisë për Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundëshme për tu shpallur “Peizazh i mbrojtur”.

-Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve

Ujerat qe do te dalin nga procesi i pasurimit te mineralit do te riciklohen dhe do te rifuten serish ne proces, ajo pjese e vogel e ujerave qe do te shkarkohen ne mjedis ujqor para se te shkarkohet nga vaskat e dekantimit ne mjedisin ujqor prites neutralizohet me acid per neutralizimin e pH nga 11 shkon ne 7.

Procesi i pasurimit te bakrit nuk perdore lende djegese dhe nuk ka emetim te gazeve ndotes ne atmosfere. Energjia elektrike qe do perdoret per venien ne funksion te pajisjeve edhe burim i paster energjie. Te vetmet emetime ne ajer do te vijne nga djegia e lendes djegese te mjeteve te transportit, por qe do te jete ne nivele te paperfillshme.

Ne repartin e thyerjes pluhurat qe krijohen dalin ne atmosfere nepermjet sistemit te ventilimit., pasi kalojne ne filtrat e instaluar per kete qellim. Grimcat e hedhura ne atmosfere edhe nen veprimin e eres nuk shperndahen me larg se rreth 100 m nderkohe qe shtepite me te aferta nga vendi ku do te ndertohet fabrika jane poshte autostrades ne distance rreth 800 deri 1000m. E thene ndryshe keto pluhura kane zero ndikim ne komunitet.

Sterilet qe do te dalin nga procesi i pasurimit nuk shkaktjne ndotje te tokes, ato do te depozitohen ne karrieren ekzistuese , kane te njejten perberje mineralogjike me token. Nuk do te kemi ndikim ne ajer nga zhvillimi I aktivitetit sterilet nuk krijojne pluhura gjate transportimit dhe depozitimit ne kariere sepse kane permbajtje te larte uji nga procesi i pasurimit. Pas depozitimit dhe tharjes se tyre nga kushtet atmosferike do te mbulohen me sterile te karrieres per te mos lejuar ngritjen e grimcave te imeta ne atmosfere, duke patur parasysh qe keto grimca kane nje granulometri te vogel.

Te vetmet emetime ne ajer do te vijne nga djegia e lendes djegese te mjeteve te transportit, por qe do te jete ne nivele te paperfillshme.

-Ndikimet sociale te projektit , te tilla si ndryshimi i perdorimit te tokes dhe shqetesimet qe mund te lindin nga ndikimet ne mjedis te projektit (si zhurmat, pluhuri, perdorimi i burimeve natyrore etj).

Zbatimi projektit nuk kerkon ndryshime ne popullsi, spostime te zonave te banuara ose krijimin e zonave te reja banimi,etj. Aktiviteti do te behet ne nje zone te kufizuar ne krahasim me siperfaqen dhe popullsine e rajonit. Per zhvillimin e aktivitetit nuk do perdoret toke shtese vec asaj te miratuar per ndertimin e fabrikes. Zhurmat qe do te krijohen nga mjetet e nivelimit te te sheshit per ndertimin e fabrikes, ngarkimit dhe transportimit te mineralit nga karriera ne fabrike jane ne nivele te pranueshme dhe nuk do perbejn problem shqetesues per banoret e zones ne afersi.

Burimet e zhurmave jane ne siperfaqe. Cdo burim perhap vale zhurme. Fusha akustike qe rezulton varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimeve te te gjitha pengesave ekzistuese, ndermjet burimit dhe receptorit.

Energjia zvoglohet per gjate rruges si rezultat i absorbimit te siperfaqeve,divergjences gjeometrike dhe absorbimit atmosferik.

Paisjet e makinerit qe do perdoren ne kete aktivitet do plotesojne direktiven 2000/1/14/CE te Parlatmetit Evropian dhe e KE 8 maj 2000, do jene te standartit te aplikueshem ne BE per zhurmat.

- Ne varesi te natyres se projektit nje pershkrim i aksidenteve te mundshme me pasoja ne mjedis
Rreziqe me pasoja ne mjedis

1. Demtim habitatesh ne zonen ku do te kryhet aktiviteti
2. Renien e ndonje zjarri ne ambjentin e fabrikes

Rreziqet me pasoja ne mjedisin human dhe ekonomik

- Aksidentet e punonjesve gjate procesit teknologjik ne objekt.
- Aksidentet si pasoje e renies se zjarrit.

Probabiliteti i ndodhjes per secilin nga rastet e me siperm do te varet shume nga masat mbrojtese qe do te parashikohen dhe zbatohen. Zhvillimi i aktivitetit nuk shoqerohet me aksidente te cilat mund te sjellin pasoja te demshme ne mjedis si ndotje te ujerave nga lende te rrezikshme, emetime ne ajer nga gaze helmuese apo kontaminim te tokes. Aktiviteti I pasurimit te bakrit do te behet sipas projektit dhe ne sasine dhe kohen e parashikuar. Por duke e pare ne kontekstet e funksionimit te fabrikes mund te themi se do te kete ndikim pozitiv ne popullsine e zones, duke kontribuar drejtpersedrejti ne rritjen e mireqenies se tyre ne permisimin e infrastruktures se zones dhe punesimin e tyre.

- Lloji i ndikimeve te identifikuara (Direkte dhe Jodirekte)

Ndikimet e identifikuara nga zhvillimi i aktivitetit jane ndikime direkte ne mjedis.

Tabela e indentifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne toke.

	Ndikimi i mundshem	Sqarim
1	Derdhja pa dashje e vajrave dhe lubrifikanteve nga mjetet e punes.	Behet fjale per ndonje rast te rralle te rrjedhjes gjate difekteve dhe çarje te tubave dhe sotokartit te mjeteve motorike dhe nderrimit te vajrave ne makinerite e karieres gjate prodhimit dhe transportit te mineralit.

Tabela e indentifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne ajer.

	Ndikimi i mundshem	Sqarim
1	Shkarkimi i gazeve ne sasi minimale nga lenda djegese	Sasia e gazeve nga djegia e karburantit qe do te shkarkohet nga mjetet motorrike. Eshte standart i teknologjise se prodhimit te mjeteve dhe i karburantit.
2	Emetimi i zhurmave nga puna e makinerive .	Vlerat standart te emetimit te zhurmave sipas teknologjise se prodhimit te makinerive, kontroll teknik te makinerive.

Tabela e indentifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne biodiversitet.

	Ndikimi i mundshem	Sqarim
1	Shqetesim i mundshem i faunes.	Ndikim i perkoshem.

- Mundesia e zbutjes se ndikimeve dhe argumentimet perkatese nese per ndikime te caktuara nuk mund te batohen/ ndermerren masa zbutese

Referuar natyres se procesit nuk kemi sasi gazesh te shkarkuar ne atmosfere, Gazet prej mjeteve te punes jane ne intervale kohore te shkurtra , brenda normave te lejuara pa ndonje ndikim negativ ne mjedisin perreth. Këto lloj mjetesh emetojnë sasira gazesh të cilat janë rezultat i punës së motorrave me djegie të brendëshme, brënda normave të lejuara. Këto mjete para se të vihen në punë janë objekt i kontroleve teknike vecanerisht për emetimet e gazta.

Per mbrojtjen nga gazet e motorreve dizel do te merren keto masa :

Mjetet motorrike do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore.

Ato do te jene te pajisura ne marmita me katalizatore per kapjen e gazeve toksike.

Meqenese qendrat e banuara jane ne nje distance relativisht te konsiderueshme nga zona e ku do te ndertohet fabrika keto emetime nuk ndikojne ne to.

Gjithashtu nuk do te kete ndikim tek punonjesit e karieres, floren dhe faunen per rreth saj, e cila nga aktiviteti I meparshem I minieres dhe uzines ne Rexhepaj eshte e demtuar . Per zbutjen e ketyre ndikimeve punonjesit do te pajisen edhe me mjete mbrojtese.

Zhurmat qe krijohen vijne nga levizja e makinerive, jane te pranishme por nuk perbejn rrezik dhe shqetesim per mjedisin sepse zonat e banuara jane ne nje distance te konsiderueshme. Per mbrojtjen nga zhurma te njerezve nga ana e shoqerise do te punohet ne dy drejtime

- Ne fabrike do te perdoren makineri dhe pajisje te teknologjise se larte te pajisura me amortizues te zhurmave
- Punonjesit do te pajisen me mjete mbrojtese sipas rregullores se sigurimit teknik.

- *Zonat e ndjeshme ndaj ndikimeve te projektit (zona te mbrojtura dhe habitate, qendra te banuara, burime ujore, zona arkeologjike etj)*

Si rezultat i zbatimit te projektit ne kete zone nuk ka ndikim negativ mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike dhe mbi vepra te tjera njerezore, sepse ne kete zone nuk ka asnje objekt te nje rendesie te vecante te karaktereve te lartpermendura. Kjo tregon qe zona eshte zone e lire jo vetem per te realizuar ndertimin e fabrikes , por njekohesisht nje zone ne te cilen aktiviteti nuk shoqerohet me pasoja ndotese per mjedisin.

6. NDIKIMET NE MJEDISIN NDERKUFITAR TE PROJEKTIT (NESE KA TE TILLA)

Njesia Administrative Terthore shtrihet teresisht ne kufi me Kosovën. Dogana e Morinit, qe ndodhet ne territorin e kesaj komune, eshte nje nga Doganat me te rendesishme te vendit. Fabrika e pasurimit te bakrit do te instalohet ne afersi te karieres se shfrytezimit te bakrit ne fshatin Gjegjan , e cila eshte nja nga zonat me te njohua per nxjerrjen e mineralit te bakrit. Zhvillimi I ketij aktiviteti nuk do te kete ndikim nderkufitar .

7. NDIKIMET POZITIVE NE MJEDISIN E ZONES SE PROJEKTIT

Shfrytezimi i burimeve natyrore dhe vecanerisht minerare eshte domosdoshmeri ashtu sic eshte domosdoshmeri shfrytezimi i shume burimeve te tjera natyrore. Shfrytezimi i tyre duhet ber sipas projekteve te hartuara nga ekspertet duke zbatuar ligjet ne fuqi. Nje pjese e ketyre mineraleve i nenshtrohen edhe proceseve te metejshme per te patur ne fund produktin e deshiruar te mineralit. Minerali i bakrit do ti nenshtrohet proceseve te pasurimit te tij ne fabrike qe do te ndertohet nga shoqeria. Si rrjedhoje e zbatimit te projektit per pasurimin e bakrit nuk ka ndikime pasuese mjedisore. Ne projekt, nuk perfshihen ndryshime ne popullesin e zones, te zhvendosjes se saj per shkak te aktivitetit. Ne territorin e zbatimit te projektit nuk ka qender te banuar, banesat me te aferta jane mbi 800 m, prandaj dhe nuk do te kete ndikime ne popullsi.

Zhvillimi i aktivitetit do te bej te mundur pasurimin e mineralit te bakrit te cilin shoqeria e siguron nga shfrytezimi i vendburimit te bakrit ne Gjegjan.

Zhvillimi i ketij aktiviteti do te sjell ndikim pozitiv ne punesimin e banoreve te zones te cilet kane edhe eksperiencen e duhur ne kete fushe, duke qen se dikur ka funksionuar miniera e shfrytezimit te bakrit ne Gjegjan. Punesimi i tyre do te sjell edhe rritjen dhe permiresimin e cilesise se jeteses.

Gjatë zbatimit të aktivitetit nuk do kete ndryshime të rrjetit të rrugëve lokale dhe transportit. Për rrjedhojë aktiviteti nuk do ndikojë absolutisht në rrugët lokale dhe transport, përkundrazi subjekti është angazhuar të mirembajë rrugët lokale të transportit me qëllim të mbarvajtjes së mirë të aktivitetit të tij.

8. MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV TE IDENTIFIKUAR

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate punimeve, ne ajer, te pluhurave dhe zhurmave, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore te territorit , faunen dhe floren. Me qellim minimizimin e efekteve negative mjedisore dhe rritjes se efekteve pozitive ne mjedis, nga ana e shoqerise do merren masa per zbutjen dhe minimizimin e efekteve negative ne mjedis.

Masat qe do te merren per zbutjen e ndikimit

Ndikimet mjedisore te projektit do te zbuten duke zbatuar me korrektesi teknikat e meposhtme:

- Piketim te sakte te siperfaqes ku do te ndertohet fabrika e pasurimit
- Hapjen e kanaleve te nevojshem me qellim drejtimin e ujerave te shiut dhe erozionit per parandalimin e shembjes se siperfaqes dhe vithisjeve te ndryshme.
- Kontroll teknik i mjeteve te punes per te parandaluar rrjedhjet e karburantit dhe aksidentet e mundshme
- Do te zbatohen me rigorozitet kushtet e sigurit teknik per punonjesit
- Per mbrojtjen nga gazet e motorreve dizel do te merren keto masa.

Mjetet motorrike do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore. Ato do te jene te pajisura ne marmita me katalizatore per kapjen e gazeve toksike.

Meqenese qendrat e banuara jane ne nje distance relativisht te larget nga zona e zhvillimit te aktivitetit , keto emetime nuk ndikojne ne to.

Gjithashtu nuk do te kete ndikim tek punonjesit e karieres, floren dhe faunen per rreth saj.

- Ne repartin e thyerjes pluhurat qe krijohen dalin ne atmosfere nepermjet sistemit te ventilimit., pasi kalojne ne filtrat e instaluara per kete qellim. Grimcat e hedhura ne atmosfere edhe nen veprimin e eres nuk shperndahen me larg se rreth 100 m nderkohe qe shtepite me te aferta nga vendi ku do te ndertohet fabrika jane poshte autostrades ne distance rreth 800 deri 1000m. E thene ndryshe keto pluhura kane zero ndikim ne komunitet.
- Ujerat qe do te dalin nga procesi i pasurimit te mineralit do te riciklohen dhe do te rifuten serish ne proces, ajo pjese e vogel e ujerave qe do te shkarkohen ne mjedis uhor para se te shkarkohet nga vaskat e dekantimit ne mjedisin uhor prites neutralizohet me acid per neutralizimin e pH nga 11 shkon ne 7.
- Sterilet nuk krijojne pluhura gjate transportimit dhe depozitimit ne kariere sepse kane permbajtje te larte uji nga procesi i pasurimit. Pas depozitimit dhe tharjes se tyre nga kushtet atmosferike do te mbulohen me sterile te karrieres per te mos lejuar ngritjen e grimcave te imeta ne atmosfere, duke patur parasysh qe keto grimca kane nje granulometri te vogel.

Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjitha treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes do te çojne perfundimisht ne nje proces pune te kontrolluar me shkarkime brenda normave, duke mos sjelle pasoja per shendetin e njerzve dhe mjedisin perreth.

9. PROGRAMIN E MONITORIMIT TE NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT

Me VKM per programin e monitorimit jepen qarte indikatoret mjedisore qe monitorohen, megjithate keta indikator duhet te pershtaten dhe ti perkasin veprimtarise.

Qellimi i monitorimit mjedisore per veprimtarine e projektit te zbatuar eshte qe te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet ne se operimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standartet mjedisore qe lidhen me te, si dhe per te vleresuar performancen mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem.

Nr	Elementi i monitorimit	Frekuenca
1	Monitorim i zhurmave te mjeteve ne fazen e ndertimit te fabrikes dhe gjate funksionimit te saj ngarkimit -transportit te mineralit prane qendrave te banuara.	Vazhdimisht
2	Monitorimi i sjelljes se bimesise se zonen rreth zones ne nje distance me rreze 200 ml.	Vazhdimisht
3	Monitorim i pluhurave ne proceset e hapjes se rruges dhe ngarkimit- shkarkimit te mineralit nga karriera ne fabrike.	Ne stinen e thate dhe kohe me ere
4	Monitorimi i gjendjes se paisjeve e makinerive, veçanerisht mjeteve te ngarkimit dhe transportit dhe mundesise per rrjedhje te karburantit dhe ndotje.	Vazhdimisht
5	Monitorim i faktoreve qe shkatojne fatkeqesi humane	Vashdimisht
6	Monitorim i sjelljes se bimesise se mbjelle gjate rehabilitimit	Vjetore

10. PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT

- rolet dhe pergjegjesite per zbatimin e seciles mase te propozuar per mbrojtjen e mjedisit ne secilen faze te projektit

Problemet e gjenerimit te mbetjeve dhe administrimit te tyre jane minimale.

Per te shmangur dhe menaxhuar sa me mire ndikimet negative ne mjedis te shkaktuara nga elementet e pershkruar me siper, subjekti nepermjet personelit te tij harton dhe zbaton nje plan efikas menaxhimi te ndikimit ne mjedis. Ne perpilimin e Planit te Menaxhimit dhe analizimin e tij eshte vrejtur se realizimi me sukses i ketij plani sjell nje sere perfitimesh per shoqerine te tilla si: ushtrimi i veprimtarise ne perputhje me ligjet dhe rregulloret, mardhenie te mira me publikun dhe ambientalistet, shmangia e penaliteteve nga organet e kontrollit te mjedisit etj.

Parimet e zbatueshme te programit te menaxhimit te elementeve me ndikim ne mjedis jane paraqitur me poshte nga ana e stafit drejtues i konsultuar me stafe inxhinerike dhe drejtues te objektit. Detajimi i parandalimit, kontrollit dhe nderhyrjeve te stafit te linjes ne elementet e

veçante dhe delikate sipas nje table te kuadrit logjik eshte mjaft domethenes per inisjativen dhe pergjegjesine.

Filozofia e ketij plani mbeshetet ne keto parime te zbatueshme.

Ç`fare	Si	Kush
Parandalim	Perzgjedhja e teknologjise plotesisht te kontrolluar dhe moderne me pajtuesmeri mjedisore. Paisja e territorit te aktivitetit dhe ambjenteve te punes me sisteme perballimi te emergjencave. Zbatim rigoroz i rregullave te sigurimit teknik gjate punes dhe nderprerjes se saj duke zbatuar normat e vendosura per kete qellim kur konstatohet shkelje. Perdorimi i mjeteve mbrojtese ne pune. Plotesimi i gjithe dokumentacionit figurativ qe ka te beje me zbatimin e rregullave te manovrimit per çdo paisje, rregullave te sigurimit teknik dhe mbrojtjes ne pune si dhe atyre kundra zjarrit. Ne vendet te dukshme dhe me shkalle te larte rreziku te vendosen parrulla paralajmeruese. Kontrolli mjekesore periodik i punonjesve. Tokezimi i te gjitha paisjeve qe punojne me energji elektrike per te shmangur aksidente me pasoja	Subjekti .
Kontroll	Paisjen me mjetet e mbrojtjes nga zjarri (MNZ) Sigurimi i te gjitha pajisjeve te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash. Sigurimi i ambalazhuesve te sigurt dhe rezistent per mbetjet (kazan, kova, kosha , qese etj).	Subjekti dhe stafi i tij
Nderhyrje	Riparim i menjehershem i difekteve dhe avarive teknologjike. Aktivizim i menjehershem i stafit dhe mjeteve te fikjes se zjarrit. Njoftim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambulanca).	Personeli dhe organet shteterore te specializuara
Administrim	Perdorimi dhe ruajtja me pergjegjesi i te gjithe infrastruktures dhe mjeteve te pershkruara me siper.	Stafi i kompanise

11. KONKLUZIONE

- Aktiviteti qe do te zhvillohet me masat qe do te merren nuk do te sjelle ndotje te mjedisit
- Me e rendesishme per tu theksuar ne perfundim te ketij raporti te VNM-se eshte se ai do ti vij ne ndihme mbrojtjes se mjedisit
- Territori ku do te ndertohet farbika e pasurimit te bakrit ndodhet ne afersi te karrieres se vendburimit Gjegjan e cila eshte shfrytezuar edhe vite me pare, nuk ka ndonje status te vecante qe pengon zhvillimin e ketij aktiviteti
- Me masat qe do te merren aktiviteti nuk do te kete ndikime negative ne toke dhe nuk do te ndikojte ne ujerat siperfaqesore dhe nentokesore sepse nuk shkarkon ujera te ndotura. Pjesa me e madhe e ujit qe do te perdoret do te riciklohet, pjesa tjeter do te kaloje ne vaska dekantuese ku do te neutralizohet edhe Ph , para se te shkarkohet ne mjedisin ujqor
- Ne perfundim te aktivitetit do te behet rehabilitimi i zones
- Aktiviteti i ndertimit te fabrikes se bakrit do te kete impakt pozitiv pasi do te ndihmoj ne hapjen e vendeve te reja te punes, per popullsine e zones.
- Fabrika do te siguroj koncentratin e bakrit nga procesi i pasurimit te ketij minerali

Materiali u pergatite nga

STUDIO PROJEKT shpk

Ekspert Mjedisi Ing. Miniere Xhevair DERMISHI

Gjeoinxhinier Ermir DERMISHI

Ing. Mjedisi Arvena FEJZULLAI

Ing.Kimiste Anxhela BULLATI

Ing. Pyjesh Gerti BRAHIMI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 331 Prot.

Tirane, me 09.09. 2004

Vendimi Nr.11, Nr.086Regj.

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Xhevair DERMYSHI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Ethem RUKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes

LICENCË



LN-0042-06-2009	NUIS/NIPT: K62021001S
Emërtimi përshkrues i veprimtarisë Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor, vlerësimi i ndikimit në mjedis)	
Subjekti: STUDIOPROJEKT	
Adresa: Tiranë, TIRANË, Tiranë, Rruga Frosina Plaku (Perballë Klubi Partizani), 51/6	
Kodi: III.2.A (1+2)	Kod tjetër:
Data e lëshimit: 27/03/2014	Afati i vlefshmërisë: Pa afat
Kategoria	Kufizime specifike
Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis	Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi
Nënkategoria	Detyrime specifike
Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis	Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi
Veprimtari specifike	Vendi i kryerjes së veprimtarisë
1. Ndikim në mjedis 2. Auditim mjedisor	Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
Specialiteti	Nëshkrimi i sportelit: <i>Dolyma Steja</i>

